



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

3 shkurt 2022, Prizren

Punë praktike gjashtë mujore në EC MA NDRYSHE

Në kuadër të Programit të Praktikës, EC ofron punë praktike me kohëzgjatje gjashtë mujore. Programi është i hapur për studentët/et e të gjitha drejtimeve, të cilët/at janë të interesuar/a për të marrë njohuri dhe përvoja të reja dhe për të kontribuar në punën e organizatës.

Përshkrimi i punës praktike

Praktikantët/et e zgjedhur/a do të jenë pjesë e rregullt e stafit dhe punës së organizatës dhe gjatë gjashtë muajve të angazhimit, ata/ato do të:

- Punojnë me orar të shkurtuar (4 orë në ditë),
- Përfitojnë kompensim simbolik financiar në baza mujore,
- Asistojnë në realizimin e aktiviteteve brenda projekteve dhe iniciativave ekzistuese,
- Aftësohen në menaxhim dhe në temat e ekspertizës (gjithëpërfshirja dhe mobilizimi i komunitetit, planifikimi urban, trashëgimia kulturore, mjedisi, transparenca)
- Përfitojnë nga skema e zhvillimit të kapaciteteve brenda dhe jashtë Kosovës (trajnime, punëtori, Shkolla, vizita studimore)
- Konsiderohen për angazhim si staf i rregullt i organizatës në rast të performansës së mirë gjatë periudhës së punës praktike.

Gjatë angazhimit të tyre, praktikantët/et do të mbikëqyren nga stafi menaxherial i organizatës dhe do t'i nënshtrohen vlerësimit mujor të punës.

Kohëzgjatja e praktikës:

Një cikël i punës praktike zgjat gjashtë muaj dhe me mundësi vazhdimi edhe për tre deri gjashtë muaj shtesë. Pas përfundimit të programit, praktikantët/et do të pajisen me dëshmi përkatëse.

Orari i punës dhe të drejtat e përfitimit

Praktikantët/et do të jenë të vendosur/a në zyrat e EC në Prizren dhe Prishtinë dhe do të punojnë me orar të përgjysmuar, çdo ditë pune nga katër orë në ditë. Pjesë e këtij orari të angazhimit, përveç punës në zyrën e organizatës, do të jetë edhe angazhimi në terren, për shkak të natyrës së punës komunitare që realizon organizata. Praktikantëve/eve, përveç kompensimit simbolik financiar në baza mujore dhe skemës për zhvillimin e kapaciteteve, do t'u sigurohen edhe të gjitha të drejtat e garantuara me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës.

Kriteret minimale

Për t'u kualifikuar për programin e praktikantëve/praktikanteve, kandidati/ja duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 18 vjeçar/e ose mbi këtë moshë,
- Student/e me aftësi minimale në menaxhim organizativ,

- Njohje të gjuhëve lokale dhe të gjuhës angleze (kriter jo-obligativ),
- Shkathtësi në përdorimin e programeve kompjuterike dhe mediave sociale,
- I gatshëm / E gatshme për të filluar punën praktike gjatë muajit Mars 2022.

Aplikimi:

Për të aplikuar, ju lutem plotësoni formën e aplikimit që gjendet në këtë link:

<https://forms.gle/w5NV1mRWFZK22ZhQ9>

Afati i fundit për aplikim është deri më 20 shkurt 2022

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci, Nr. 94 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 77